

MARRËVESHJE

NË MES TË

ZYRËS SË KRYEPROKURORIT TË EULEX-IT

DHE

AGJENSIONIT KOSOVAR KUNDËR KORRUPSIONIT

LIDHUR ME

**BASHKËPUNIMIN NË MES TË PROKURORËVE TË EULEX-IT DHE AGJENSIONIT
KOSOVAR KUNDËR KORRUPSIONIT**

Kryeprokurori i EULEX-it dhe Agjensioni Kosovar kundër Korrupsionit,

Pranojnë që një bashkëpunim i ngushtë me qëllim të këmbimit të informatave dhe konstatimeve, në përputhje me mandatet përkatëse, në mes të Zyrës së Kryeprokurorit të EULEX-it dhe Agjensionit është i nevojshëm, në mënyrë që të sigurohet një luftim më i efektshëm ndaj fenomeneve kriminale të lidhura me korrupsionin, dhe

Prandaj arrijnë këtë Marrëveshje

PJESËMARRËSIT E MARRËVESHJES

Palët e kësaj Marrëveshjeje janë:

- Zyra e Kryeprokurorit të EULEX-it, dhe
- Agjensioni Kosovar kundër Korrupsionit (më tej “Agjensioni”).

QËLLIMI I MARRËVESHJES

Marrëveshja do të kontribuojë për të siguruar një bashkëpunim të efektshëm në mes të Agjensionit dhe Prokurorëve të EULEX-it, përmes këmbimeve të sakta të informatave në mes të dy palëve.

IMPLEMENTIMI I MARRËVESHJES

1. Zyra e Kryeprokurorit të EULEX-it do të ketë të drejtë t'i dërgojë ankesat e pranuar nga Prokurorë të ndryshëm të EULEX-it të vendosur në Kosovë, te Agjensioni (përmes Drejtorit të saj), për vlerësimin e tyre, sipas mandatit të përcaktuar me Ligj.
2. Zyra e Kryeprokurorit të EULEX-it mund t'i delegojë Prokurorët e EULEX-it të vendosur në Kosovë që ankesat përkatëse t'i paraqesin drejtpërdrejt në Agjencion.
3. Sipas nevojës dhe kur konsiderohet e përshtatshme, Agjensioni do të ndërmarr çfarëdo veprimi (hetime administrative ose të tjera), sipas mandatit, mbi ankesat e transferuara nga Zyra e Kryeprokurorit të EULEX-it dhe/ose nga Prokurori i deleguar i EULEX-it.
4. Agjensioni do të ketë të drejtë të paraqes te Zyra e Kryeprokurorit të EULEX-it çfarëdo informate ose çfarëdo konstatimi lidhur me aktivitetet e veta institucionale (përfshirë mundësinë e hetimit), prej të cilave mund të jetë e mundshme të konstatohen bazat e një hetim penal.
5. Gjatë përmbushjes së mandatit, Agjensioni do të ketë të drejtë ta informojë Kryeprokurorin e EULEX-it për çfarëdo rasti në të cilin ajo konsideron se ka mosdashje nga ana e Prokurorëve të Kosovës për ti hetuar dhe/ose ndjekur aktivitetet kriminale që u janë bërë me dije prokurorive të qarkut dhe/ose atyre komunale.
6. Me kërkesë të Drejtorit të Agjencionit, Kryeprokurori i EULEX-it mund të ndërmarr çfarëdo hapi për të kontrolluar cilindo rast në hulumtim e sipër ose të mbyllur lidhur me deklaratat për fenomene korruptive që trajtohen ose janë duke u trajtuar nga Prokurorët e Kosovës. Gjatë kësaj, Kryeprokurori i EULEX-it do të veprojë sipas Nenit 9 të Ligjit për Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, dhe mund ta delegojë këtë funksion, sipas rastit, te cilido Prokuror i EULEX-it.
7. Në rast të rekomandimit për hetim penal, të parashtruar nga Agjensioni, te Zyra e Kryeprokurorit të EULEX-it, informatat përkatëse do të kanalizohen – kur konsiderohet e nevojshme – tek Prokurori relevant i EULEX-it për qëllime hetimore ose monitoruese. Agjensioni do të informohet përmes drejtorit të saj dhe me kërkesë të tij/saj, lidhur me zhvillimet e lëndëve penale, por pa e cenuar konfidencialitetin e hetimeve. Agjensioni gjithnjë do të informohet lidhur me vendimin përfundimtar në fund të hetimit.

DETYRAT E PALËVE

8. Çdo kumtesë dhe dokument i adresuar nga Agjensioni për Zyrën e Kryeprokurorit të EULEX-it mund të shkruhet në njërën nga gjuhët zyrtare.
9. Çdo kumtesë dhe dokument që është drejtuar nga Agjensioni në Zyrën e Kryeprokurorit të EULEX-it do të përkthehet në gjuhën angleze nga Zyra e Drejtorit të Agjensionit dhe Zyra e Kryeprokurorit të EULEX-it, sipas lëndës, me përjashtim të rasteve kur palët merren vesh ndryshe.
10. Çdo kumtesë dhe dokument që është drejtuar nga Zyra e Kryeprokurorit të EULEX-it në Agjension do të përkthehet në njërën gjuhë zyrtare të Kosovës nga Zyra e Drejtorit të Agjensionit dhe Zyra e Kryeprokurorit të EULEX-it, ashtu siç është e përcaktuar me rregulla të përgjithshme ose sipas lëndës.
11. Agjensioni, Zyra e Kryeprokurorit të EULEX-it, si dhe personeli përkatës nuk do të përhapin përmbajtjen e kumtesave dhe dokumenteve të palët e treta, me përjashtim të rasteve kur kjo është e nevojshme për përmbushjen e mandatit të EULEX-it në Kosovë.
12. Palët do ta ekzekutojnë këtë marrëveshje në mirëbesim dhe të gjithë ata do të pajtohen me faktin se dispozitat e kësaj marrëveshje do të interpretohen në një mënyrë që favorizon përmbushjen e mandatit të EULEX-it në Kosovë.
13. Dispozitat e kësaj marrëveshje nuk do të ndikojnë negativisht ose nuk do të kufizojnë autoritetin dhe kompetencat e Prokurorëve të EULEX-it të pranuar nga ligji i zbatueshëm, si dhe mundësinë që Kryeprokurori i EULEX-it dhe Drejtori i Agjensionit të përdorin mënyra të tjera joformale për këmbimin e informatave.

Si dëshmi për këtë, palët kanë nënshkruar këtë marrëveshje më _____(Data)

Agjensioni Kosovar kundër Korrupsionit
Drejtori

Kryeprokurori i EULEX-it